

UDHËZIM
Nr.2, datë 18.1.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR.13, DATË 19.12.2006 “PËR CAKTIMIN DHE PËRGATITJEN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, DHE MËNYRËN E NGRITJES SË GRUPEVE TË NUMËRIMIT”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 95, nenit 95/1, nenit 95/2, nenit 109/3, nenit 109/4, nenit 109/5 dhe nenit 109/6 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON:

Neni 1

Neni 6 pika 4, geramat “a” dhe “b”, ndryshojnë si më poshtë:

- a) Tavolina pune dhe 14 karrige për KZQV-në;
- b) Treshe tavolinash (vendosen në formë T-je sipas shpjegimit në skemën orientuese) me nga 14 karrige për çdo grup të numërimit të votave.

Neni 2

1. Në nenin 7 pika 6, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

I.

- A) Në bashkitë, të cilat kanë nga 2 deri 8 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e një grupi numërimi;
- B) Në bashkitë, të cilat kanë nga 9 deri në 14 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e dy grupeve të numërimit;
- C) Në bashkitë, të cilat kanë nga 15 deri në 19 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e tri grupeve të numërimit;
- D) Në bashkitë, të cilat kanë nga 20 deri në 29 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e katër grupeve të numërimit;
- E) Në bashkitë, të cilat kanë nga 30 deri në 45 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e pesë grupeve të numërimit;
- F) Në bashkitë, të cilat kanë nga 46 deri në 70 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e tetë grupeve të numërimit;
- G) Në bashkitë, të cilat kanë nga 71 deri në 100 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e dhjetë grupeve të numërimit;
- H) Në njësitë bashkiake të Tiranës, KZQV-ja cakton ngritjen e dhjetë grupeve të numërimit;
- I) Në bashkinë Durrës, KZQV-ja cakton ngritjen e dymbëdhjetë grupeve të numërimit.

II.

- A) Në komunat, të cilat kanë 2 deri 9 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e një grupi numërimi;
- B) Në komunat, të cilat kanë 10 deri 15 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e dy grupeve të numërimit;
- C) Në komunat, të cilat kanë 16 deri 19 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e tri grupeve të numërimit;
- D) Në komunat, të cilat kanë 20 deri 30 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e katër grupeve të numërimit.

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

Çdo grup numërimi përbëhet nga 13 anëtarë dhe sekretari.

3. Shtohet pika 8, si më poshtë:

Në të gjitha rastet, KZQV-ja duhet të ketë parasysh se një grup numërimi numëron jo më pak se 5 qendra votimi dhe jo më shumë 15 qendra votimi.

Neni 3

1. Pika 1 e nenit 8 ndryshohet si më poshtë:

Dhjetë ditë përpara ditës së zgjedhjeve, KZQV-ja njofton subjektet zgjedhore përkatëse të paraqesin propozimet për anëtarë të GNV-ve. KZQV-ja merr vendim për caktimin e grupeve të numërimit dy ditë para datës së zgjedhjeve.

2. Në pikën 3 të nenit 8 shtohet ky paragraf:

Në rastin kur zëvendëskryetari i KZQV-së është propozuar nga Partia Socialiste, ajo ka të drejtë të paraqesë propozime për tre anëtarë të grupit të parë të numërimit, njëri prej të cilëve caktohet nga KZQV-ja, kryetar i këtij grupi numërimi.

3. Në pikën 4 të nenit 8 shtohet ky paragraf:

Në rastin kur kryetari i KZQV-së është propozuar nga Partia Socialiste, ajo ka të drejtë të paraqesë propozime për tre anëtarë të grupit të dytë të numërimit, njëri prej të cilëve caktohet nga KZQV-ja, kryetar i këtij grupi numërimi.

Neni 4

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.